

RAPORTI I MONITORIMIT TË SHPENZIMEVE TË MINISTRISË SË MBROJTJES PËR VITIN 2023

Ministria e Mbrojtjes administron dhe menaxhon fondet publike, sipas shtatë programeve buxhetore të miratuara, konkretisht:

- 1) Programi “Planifikim, Menaxhim dhe Administrim”;
- 2) Programi “Forcat e Luftimit”;
- 3) Programi “Mbështetja e Luftimit”;
- 4) Programi “Arsimimi Ushtarak”;
- 5) Programi “Mbështetje për Shëndetësinë”;
- 6) Programi “Mbështetje Sociale për Ushtarakët”;
- 7) Programi “Emergjencat Civile”.

1. KARAKTERISTIKAT KRYESORE TË PERFORMANCËS

Për vitin 2023 evidenca e realizimit të shpenzimeve të buxhetit sipas secilit program, krahasuar me planin me ndryshime të kësaj periudhe, (përfshirë shpenzimet me financim të brendshëm, investimet dhe me financim të huaj) paraqitet, si më poshtë:

Tabela nr. 1

Nr.	Emërtimi i programit	Realizimi në %
1.	Planifikim, Menaxhim dhe Administrim	95
2.	Forcat e Luftimit	90
3.	Mbështetja e Luftimit	93
4.	Arsimi Ushtarak	96
5.	Mbështetje për Shëndetësinë	99
6.	Mbështetje për Ushtarakët	100
7.	Emergjencat Civile	69
TOTALI I MINISTRISË		92

Niveli prej 92 % është relativisht pozitiv për Ministrinë e Mbrojtjes, duke konsideruar faktin që fondet janë kursyer dhe nga procedurat e prokurimit, si dhe shpenzimet e personelit, për shkak të mosplotësimit të strukturave organike të disa njësive shpenzuese.

Ndërsa shpenzimet buxhetore për “Investime” **vetëm me financim të brendshëm**, duke përjashtuar *investimet dhe me financim të huaj*, **niveli i realizimit është 84%** dhe situata për çdo program për vitin 2023 paraqitet e tillë:

Tabela nr. 2

Nr.	Emërtimi i programit	Shpenzime korrente Viti 2023 (në %)	Shpenzime kapitale të brendshme Viti 2023 (në %)	Totali i shpenzimeve buxhetore Viti 2023 (në %)
1.	Planifikim, Menaxhim dhe Administrim	95	90	95
2.	Forcat e Luftimit	93	88	90
3.	Mbështetja e Luftimit	98	68	93
4.	Arsimi Ushtarak	95	99	96
5.	Mbështetje për Shëndetësinë	99	98	99
6.	Mbështetje për Ushtarakët	100	0	100
7.	Emergjencat Civile	76	60	69
TOTALI I MINISTRISË		96	84	92

Për të gjitha programet në nivel ministrie **realizimi i shpenzimeve korrente** paraqitet me 96%, duke variuar nga më i ulëti programi “Emergjencat Civile” me 76 %, programi “Forca e Luftimit” me 93 % programi “Planifikim, Menaxhim dhe Administrimi” me 95 %, programi “Arsimi Ushtarak” me 95%, programi “Mbështetja e Luftimit” me 98%, deri te dy programet me realizim më të lartë programi “Mbështetje për Shëndetësinë” “me 99 % dhe “Mbështetje Sociale për Ushtarakët” me 100%. Në mosrealizimin në nivelin e planifikimit të shpenzimeve operative ka ndikuar mosrealizimi në shpenzime për paga për mosplotësim të strukturave të miratuara në të gjithë programet, mosrealizimi në shpenzimet për mallra dhe shërbime si rrjedhojë e procedurave të prokurimit, i programit “Emergjencat Civile”.

Ndërsa në zërin e **shpenzimeve kapitale të brendshme, ministria paraqitet me realizim prej 84%.**


Duke iu referuar Aneksit nr.1 të monitorimit për shpërndarjen e buxhetit, ndër 7 programet e ministrisë, më poshtë po paraqesim strukturën e shpenzimeve për çdo program, sipas buxhetit fillestar, buxhetit me ndryshime në nivel vjetor dhe faktit të realizuar gjatë të vitit 2023:

Tabela nr. 3

Emërtimi i programit	Struktura e shpenz. sipas buxhetit fillestar të vitit 2023 në %	Struktura e shpenz. sipas buxhetit me ndryshime të vitit 2023 në %	Struktura e shpenz. sipas faktit i vitit 2023 në %
Planifikim, Menaxhim dhe Administrim	4	5	5
Forcat e Luftimit	45	42	44
Mbështetja e Luftimit	19	19	20
Arsimi Ushtarak	3	3	3
Mbështetje për Shëndetësinë	4	4	5
Mbështetje për Ushtarakët	13	15	17
Emergjencat Civile	11	13	6
Totali i shpenzimeve të Ministrisë	100	100	100

Grafiku Nr.1

Struktura e shpenzimeve faktike e shprehur në % për Ministrinë Mbrojtjes, sipas programeve për vitin 2023.



Rreth 44 % të totalit të shpenzimeve faktike të kryera gjatë këtij viti e ka programi “Forcat e Luftimit”, ndjekur nga shpenzimet për programet “Mbështetja e Luftimit” me 20 %, “Mbështetje për Ushtarakët” me 16%, “Mbështetje për Shëndetësinë” me 4.5 %, “Planifikim, Menaxhim dhe Administrim” me 5 %, “Arsimi Ushtarak” me 3 % dhe “Emergjencat Civile” me 7.6 %.

Nga monitorimi konstatohet se struktura e shpenzimeve ndërmjet programeve në parashikimet sipas **buxhetit fillestar dhe buxhetit me ndryshime, ka ndryshime në disa programeve** buxhetore (e shprehur në % të përafërt ndryshimet nuk janë të konsiderueshme).

Duke krahasuar strukturën e programeve sipas realizimit faktik gjatë periudhës dhe buxhetit me ndryshime konstatohet se në dy programe ka rritje dhe në pesë programe ka ulje.

Buxheti i Ministrisë së Mbrojtjes paraqitet me ulje në vlerën **4,998,388** mijë lekë për vitin 2023, sipas çdo programi, konkretisht ndryshimet paraqiten:

“**Planifikim, Menaxhim dhe Administrimi**”, buxheti i rishikuar në krahasim me buxhetin fillestar ka rritje me 84.156 mijë lekë.

“**Forca e Luftimit**”, buxheti i rishikuar në krahasim me buxhetin fillestar ka ulje me **3,524,918** mijë lekë.

“**Mbështetja e Luftimit**”, buxheti i rishikuar në krahasim me buxhetin fillestar ka ulje me **1,026,851** mijë lekë.

“**Arsimi Ushtarak**”, buxheti i rishikuar në krahasim me buxhetin fillestar ka ulje me **341,861** mijë lekë.

“Mbështetje për Shëndetësinë”, buxheti i rishikuar në krahasim me buxhetin fillestar ka ulje me **128,446** mijë lekë.

“Mbështetje për Ushtarakët”, buxheti i rishikuar në krahasim me buxhetin fillestar ka rritje me **80,308** mijë lekë.

“Emergjencat Civile”, buxheti i rishikuar në krahasim me buxhetin fillestar ka ulje me **140,776** mijë lekë.

Niveli i realizimit në vlerë sipas strukturës së tyre në buxhetin e ministrisë për vitin 2023 paraqitet në tabelën dhe grafikun e mëposhtëm:

Tabela nr. 4

në 000/lekë

Nr.	Emri i programit	Buxheti me ndryshime 12-mujori (limiti)	Struktura në %	Fakti 12-mujori i vitit 2023		
				në 000/ lekë	Realizimi në% (përfshirë investimi me financim të huaj)%	Realizimi në% (pa përfshirë investimi me financim të huaj)%
1.	Planifikim, Menaxhim dhe Administrim	1,687,880	5	1,596,145	95	95
2.	Forcat e Luftimit	14,735,582	42	13,306,430	90	90
3.	Mbështetja e Luftimit	6,632,808	19	6,178,973	93	93
4.	Arsimi Ushtarak	1,021,559	3	982,515	96	96
5	Mbështetje për Shëndetësinë	1,480,090	4	1,464,495	99	99
6.	Mbështetje për Ushtarakët	5,280,308	15	5,280,308	100	100
7.	Emergjencat Civile	4,419,524	13	1,737,704	39	69
Totali		35,257,751	100	30,546,570	87	92

1. PROGRAMI “PLANIFIKIM, MENAXHIM DHE ADMINISTRIMI”.

Në bazë të informacioneve të paraqitura, drejtuesit e njësive shpenzuese, ku fondet e akorduara për këtë program buxhetor përbëjnë rreth 4.8 % të buxhetit me ndryshime të miratuar për MM-në për vitin 2023. Për këtë program janë parashikuar objektiva specifike. Për vitin 2023 disa nga objektivat kryesorë janë:

1. Sigurimi i menaxhimit eficient dhe efektiv të burimeve financiare, njerëzore dhe materiale në strukturat e Ministrisë së Mbrojtjes.
2. Modernizimi i infrastrukturës së Ministrisë së Mbrojtjes.
3. Funksionimi eficient i sigurt, si dhe modernizim i mëtejshëm i infrastrukturës së teknologjisë dhe informacionit.

Fondet e miratuara për këtë program shpenzohen për realizimin e objektivave të mësipërm, nëpërmjet 3 produkteve në zërat “Shpenzime Korrente” dhe 5 projekte investimi në zërin “Shpenzime Kapitale”. Për këtë program vërejmë se ndryshimi i planit të produkteve është rritur në vlerën 84,156 mijë lekë në shpenzime korrente.

Për vitin 2023 janë parashikuar 8 produkte me vlerë 1,687,880 mijë lekë dhe janë realizuar 8 produkte me vlerë 1,596,145 mijë lekë ose 95 %.

Realizimi në këtë nivel ka ardhur si rezultat i menaxhimit efektiv të fondeve. Nga analiza e kostos së produkteve të planifikuara me koston e produkteve në fakt nuk ka ndryshime dhe në mënyrë analitike realizimi i produkteve të programit buxhetor “Planifikim, Menaxhim dhe Administrimi” paraqitet në tabelën e mëposhtme:

Tabela nr.5

në 000/lekë

Produktet	Buxheti 12-mujor i vitit 2023	Realizimi i vitit 2023		Kosto për njësi		Komente
	në (000/lekë)	Në (000/lekë)	Në %	Kostoja për njësi në Plan	Kostoja për njësi në Fakt	
Akte ligjore e nënligjore të përgatitura.	1,012,456	950,900	94	40,498.	38,036	Realizuar
Marrëveshje të realizuara	275,424	275,424	100	22,952	22,952	Realizuar
Sisteme të mirëmbajtura.	200,000	189,990	95	66,667	63,330	Realizuar
Përmirësimi në hardware, software dhe ndërtim i dhomave të serverëve (NJUSK).	23,600	23,501	100	23,600	23,501	Realizuar
Krijimi i Qendrës së Inovacionit për cyber security.	69,994	64,790	93	69,993	64,790	Realizuar
Blerje pajisje Tik për MM dhe FA.	67,243	54,438	81	149	121	Realizuar
Sistem Zjarrfikës për dhomat e serverëve.	7,564	5,460	72	7,564	5,460	Realizuar
Përmirësimi i Sistemit Financiar për MM.	31,600	31,600	100	31,600	31,600	Realizuar
TOTALI	1,687,880	1,596,104	95			

Realizimi i fondeve buxhetore sipas grupit artikujve për vitin 2023 në këtë program buxhetor rezulton, si më poshtë:

Realizimi i fondeve buxhetore për grupin e shpenzimeve korrente 95%

Realizimi i fondeve buxhetore për grupin e shpenzimeve kapitale 90%

Statusi i realizimit të këtyre produkteve është në vlerën 1,596,104 mijë lekë ose 95%.

2. PROGRAMI “FORCAT E LUFTIMIT”

Programi “Forcat e Luftimit” përmban 3 nënprograme: **Komanda e Forcës Tokësore, Komanda e Forcës Detare dhe Komanda e Forcës Ajrore**. Për secilin nga këto nënprograme janë parashikuar objektiva specifike.

Për vitin 2023 disa nga objektivat kryesorë janë:

- Objektivi 1: Mbajtja në gatishmëri dhe përmirësimi i kapaciteteve operacionale të Forcës Tokësore;
- Objektivi 2: Mbajtja në gatishmëri dhe përmirësimi i kapaciteteve operacionale të Forcës Detare;
- Objektivi 3: Mbajtja në gatishmëri dhe përmirësimi i kapaciteteve operacionale të Forcës Ajrore.

Fondet e miratuara për këtë program përbëjnë rreth 41.8 % të buxhetit me ndryshime, të miratuar për periudhën raportuese, dhe janë shpenzuar për realizimin e objektivave të mësipërme, nëpërmjet 4 produkteve në zërat “Shpenzime Korrente” dhe 19 projekte investimi në zërin “Shpenzime Kapitale”.

Për këtë program vërejmë se ndryshimi i planit të produkteve është rritur në vlerën 575,082 mijë lekë.

- Shtesë në shpenzime operative në vlerën 319,782 mijë lekë;
- Shtesë në shpenzime kapitale në vlerën 255,300 mijë lekë.

Për 12-mujorin e vitit 2023 janë parashikuar 23 produkte me vlerë 14 735 582 mijë lekë dhe janë realizuar me 13,306 430 mijë lekë ose 90.3 %.

Nga analiza e koston së produkteve të planifikuara me koston e produkteve në fakt nuk ka ndryshime dhe në mënyrë analitike realizimi i produkteve të programit buxhetor “Forcat e Luftimit” paraqitet në tabelën e mëposhtme:

Tabela nr.6

në 000/lekë							
Nr.	Produktet	Buxheti 12-mujor në (000/lekë)	Realizimi 12-mujor viti 2023		Kosto për njësi		Komente për realizimin e produkteve
			Realizimi 12-mujor në (000/lekë)	Në %	Kostoja për njësi në Plan	Kostoja për njësi në Fakt	
91702AA	Forca Tokësore në gatishmëri dhe operacionale.	2,727,407	2,631,307	97	1168	1183	Realizuar
91702AB	Kontingjent ushtarak në mision paqeruajtës jashtë vendit.	963,000	962,912	100	4815	4815	Realizuar
M170424	Armatim i lehtë, municione dhe aksesore, makineri e pajisje.	4,584,279	4,088,058	89	2292	2044	Realizuar.
18 AY915	Rikonstruksion i rrjetit të komunikimit me fibër optike.	7,300	7,201	99	7300	7201	Realizuar
18 AY916	Pajisje të sallave operacionale, ndërtesave të reja me orendi, sisteme IT-je.	36,145	36,009	100	903	900	Përfunduar
18AY909	Ndërtim objektesh dhe punime për rikonstruksione të godinave të KFT-së, Zall-Herr.	602,597	581,577	97	389	375	Realizuar

18AY918	Ndërtim i rrjetit inxhinierik i Poligonit Kombëtar Pajet.	16,000	0	0	0	0	Nuk është realizuar
18AY919	Ngritja e sistemit të sigurisë dhe i rrethimit të Poligonit Kombëtar Pajet.	16,015	0	0	0	0	Nuk është realizuar
M170411	Pagesë TVSH-je për objektet ndërtimore	2,0285	9,086	45		11199	Realizuar
91702AC	Forca Detare në gatishmëri dhe operacionale.	1,209,047	1,053,132	87	1686	1674	Realizuar
18AZ025	Predha për topin automatik 20 mm (102 HEI) të anijeve të klasit "ILIRIA".	90,000	0	0	0	0	Nuk është realizuar
18AZ022	Ndërtim i sistemit të rrjetit elektrik Maja e Thanasit, Llogara, prona nr. 1273.	7,900	0	0	0	0	Nuk është realizuar
18 AZ030	Ndërtim i sistemit autonom panele diellore (PRT dhe Vendbazimi Sazan, prona nr. 915).	19,100	0	0	0	0	Nuk është realizuar
91702AE	Forca Ajrore në gatishmëri dhe operacionale.	1,356,327	1,193,980	88	2055	1883	Realizuar
21AC101	Përmirësimi i sistemeve të teknologjisë, informacionit dhe komunikimit/Avion pa pilot/Dron	2,030,155	2,004,242	99	2030	2004	Realizuar
18AZ106	Ndërtim i perimetrit të sigurisë në Bazën Ajrore Kuçovë.	529,116	451,990	85	284	243	Realizuar
18AZ220	Punime infrastrukturore Baza Ajrore Kuçovë	124,189	73,567	59	14	10	Realizuar
M170508	Sistemi i komunikimit Tokë-Ajër-/G-A-G.	14,879	14,879	100	14.8	14.8	Realizuar
18AZ217	Shpronësim tokash Kuçovë.	22,000	18,507	84	22	19	Realizuar
18AZ221	Hangarë mjedise për mirëmbajtjen e riparimit dhe të testimit.	110,000	0	0	0	0	Nuk është realizuar
21AC108	Rikonstruksion i Shtëpisë së Ushtarakëve Kuçovë.	69,840	0	0	0	0	Nuk është realizuar
M170327	Hangarët për helikopterët Blackhawk	180	179,983	99.9	180	180	Realizuar
TOTALI		14.735.582	13.306.430	90.3			

Janë pakësuar 18 projekte në zërin "Investime", me vlerë totale 4.663.800 mijë lekë (nga të cilët një projekt investimi me financim të huaj me vlerë 4.100.000 mijë lekë).

Realizimi i fondeve buxhetore sipas grup artikujve për 12-mujorin e vitit 2023, në këtë program buxhetor rezulton, si më poshtë:

- Në shpenzime operative janë realizuar 4 produkte me vlerë 5.841.300 mijë lekë ose 93.3%;
- Në shpenzime kapitale janë realizuar 9 projekte me vlerë 7.465.100 mijë lekë ose 88%.

Statusi i realizimit të këtyre produkteve është në vlerën 13,306,430 mijë lekë ose 90 %.

3. PROGRAMI “MBËSHTETJA E LUFTIMIT”

Programi “Mbështetja e Luftimit” përmban 13 nënprograme: Komanda Mbështetëse, Instituti i Gjeografisë dhe Infrastrukturës Ushtarake, Arkivi Qendror i Forcave të Armatosura, Qendra e Kulturës, Medias, Botimeve të Mbrojtjes Muzeu i FA-së, Agjencia e Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes, Agjencia e Sistemit të Ndërlidhjes dhe Informacionit, Batalioni i Mbështetjes, Policia Ushtarake e Forcave të Armatosura, Qendra e Personel-Rekrutimit, Autoriteti i Kontrollit Shtetëror të Eksporteve, Qendra Ndërinstitucionale Operacionale Detare, Qendra e Menaxhimit të Materialeve, Kolegji i Mbrojtjes dhe Sigurisë. Për secilin nga këto nënprograme janë parashikuar objektiva specifike dhe plane veprimi për realizimin e tyre.

Për vitin 2023 disa nga objektivat kryesore janë:

- Objektivi 1: Sigurimi i logjistikës së nevojshme, si dhe mbështetja në operacione humanitare e misione ndërkombëtare.
- Objektivi 2: Sigurimi i inteligjencës strategjike të nevojshme dhe sipas standardeve të NATO-s për siguri dhe stabilitet.
- Objektivi 3: Sigurimi dhe mbështetja e sistemeve të teknologjisë brenda standardeve të NATO.
- Objektivi 4: Rritja e kapaciteteve të burimeve njerëzore dhe transformimi i sistemit të edukimit ushtarak dhe civil.

Nga analiza e kostos së produkteve të planifikuara me koston e produkteve në fakt nuk ka ndryshime dhe në mënyrë analitike realizimi i produkteve të programit buxhetor “Forcat e Luftimit” paraqitet në tabelën e mëposhtme:

në 000/lekë

Nr.	Produktet	Buxheti 12-mujor në (000/lekë)	Realizimi 12-mujor i produkteve dhe projekteve viti 2023		Kosto për njësi në (000/lekë)		Komente për realizimin e produkteve
			Realizim i 12-mujor në (000/lek)	Në %	Kostoj a për njësi në Plan	Kostoj a për njësi në Fakt	
	Emërtimi i produktit						
1.	Kapacitete Operacionale që sigurojnë mbështetjen logjistike të FARSH-it.	2,548,063	2,502,258	98	1,589	1,566	Realizuar buxheti 98%
2.	Qendra e Kulturës funksionale.	132,940	131,412	99	69	68	Realizuar buxheti 99%
3.	Arkive funksionale.	31,290	31,141	100	130	128	Realizuar buxheti 100%
4.	Personel i rekrutuar dhe dosje të administruara për trajtim financiar.	371,002	364,751	98	160	165	Realizuar buxheti 98%
5.	Sistem i Automatizuar Logjistik i Menaxhuar.	90,130	88,233	98	67	65	Realizuar buxheti 98%
6.	Licenca import/eksport të dhëna.	33,780	32,301	96	90	85	Realizuar buxheti 96%
7.	Harta ushtarake të prodhuara.	71,605	64,677	90	2400	2160	Realizuar buxheti 90%
8.	Inteligjenca ushtarake për autoritetet e drejtimit dhe komandimit të FA-së.	344,493	340,062	99	250	245	Realizuar buxheti 99%
9.	Hapësirë detare e monitoruar.	31,580	30,905	98	24	23	
10.	Polici ushtarake funksionale.	608,371	608,008	100	465	428	Realizuar buxheti 100%
11.	Sistem funksional kontrolli për FA-në	356,268	334,254	94	234	246	Realizuar buxheti 94%
12.	Objekte ne ruajtje dhe godina pushimi te ofruara.	737,020	725,518	98	656	643	Realizuar buxheti 98%
13.	Kolegji i Mbrojtjes dhe Sigurisë.	185,166	184,697	100	1850	1847	Realizuar buxheti 100%
	Totali i shpenzimeve korrente	5,541,708	5,438,217	98	1114	910	

1.	Ndërtim i Muzeut të Forcave të Armatosura	121,255	93,520	77	17,000	12,580	Realizuar 77%
2.	Ndërtim grup-depo për pajisjet e kërkim-shpëtim.	58,980	58,980	100	750	750	
3.	Rikonstruksioni i rrethimit të jashtëm/VR dhe portës hyrëse në Rep. Usht. nr. 4030.	12,510	12,510	100	2027	2027	Realizuar 100%
4.	Ndërtim sistem sigurie në Garnizonin Vaqar, Grup Depo Shkozet ,Depo Karburanti Linzë.	17,930	17,930	100	2	2	Realizuar 100%
5.	Rikonstruksion i rrethimit të jashtëm/VR dhe postbllokut të DMR Korçë.	22,386	22,386	100	1600	1600	Realizuar 100%
6.	Dizenjimi i uniformave të FA-së	7,229	7,229	100	12	12	Realizuar 100%
7.	Rikonstruksion ambientesh, blerje aparaturash mjekësore e dentare dhe pajisje orendi	98,362	97,669	99	55	199	Realizuar 99%
8.	Ndërtim objekti shumëfunksional për akomodimin e komandës, shtabit dhe kompanisë së mbështetjes në pronën nr.86 Ferraj Tiranë.	48,343	48,334	100	3856	3856	Realizuar 100%
9.	Rikonstruksion tërësor i ndërtesës së komandës dhe shtabit të batalionit.(Rep. nr.4007) dëmtuar nga tërmeti, rrethimi, sistemi i sigurisë, ndërtim depo karburanti, rikonstruksion oficine, rikonstruksion parkesh, prona nr.149 Pezë -Helmës, 50-30 mil.	36,000	0	0	0	0	Nuk është realizuar
10.	Rikonstruksion ndërtesash, rrethim pjesor, ndërtim sistem sigurie Rep. nr.4009, prona nr.176 Ferraj, Tiranë.	20,737	20,737	100	1100	1100	Realizuar 100%
11.	Rikonstruksion ndërtesë dykatëshe, ndërtim parku për mjete speciale, rikonstruksion rruge dhe sheshe për Rep Nr.4030 prona nr.86, 87 Ferraj, 40-30-35 mil.	15,423	0	0	0	0	Nuk është realizuar
12.	Rikonstruksion deposh, godina njëkatëshe, truproje, rrethim pjesor, sistem sigurie pjesore grup-depo Mengel ,prona nr.318.319 Mengël.	20,233	3,236	16	1900	304	Projekt në vijim për vitin 2024
13.	Rikonstruksion truproje, rrethim pjesor, sistem sigurie pjesor prona nr.122 Marikaj, Vorë	22,246	13,702	62	1400	868	Projekt në vijim për vitin 2024
14.	Rikonstruksion truproje porta hyrëse rrethim pjesor sistem sigurie grup depo Shkozet Durrës prona nr.215.	10,569	7,440	70	1100	770	Projekt në vijim për vitin 2024
15.	TVSH për projektet e KM-së.	13,034	12,936	99	13	13	Realizuar 99%
16.	Pajisje për Laboratorin Qendror të FA-së.	2,920	0	0	3	0	Projekt i pazhvilluar
17.	Modernizimi i pajisjeve dhe aparaturave për monitorimin e mjedisit, analizimin e CBRN.	5,080	0	0	3	0	Project i parealizuar
18.	Rikonstruksion i magazinave të kimi kateve dhe materialeve të kazermimit në depo. Aspirimi i tyre.	1,210	1,208	100	100	99	Realizuar 100%
19.	Blerje, studime, përgatitja e projekteve dhe preventivave.	59,034	57,976	98	59	57	Realizuar 98%
20.	Pajisje me programe kompjuterike, kompjuterë, serverë dhe pajisje printuese për sektorët e Institutit të Gjeografisë dhe Infrastrukturës Ushtarake.	133,296	133,296	100	10	100	Realizuar 100%
21.	Përshtatje dhe rikonstruksion ambientesh për Zyrat e Rekrutimit ne rrethe.	5,279	5,279	100	520	520	Realizuar 100%

22.	Kompletim i ambienteve për zyrat e rekrutimit në rrethe.	15,000	11,375	76	13	10	Realizuar 76%
23.	Zhvillimi i kapaciteteve O1001; K1002; S1003; S1004; L1005; N1006; N1007; R1008; I1009; M1010; M1011.	181,863	58,371	100	4	1	Realizuar 100%
24.	Printer Fotokopje Rrjeti Përqendruar.	600	300	50	2	1	Realizuar 50%
25.	Blerje pajisje TIK për Sektorin e Medias	600	591	99	6	9	Realizuar 99%
26.	Rikonstrukcion objekti ESKU dhe mbikëqyrje punimesh “EPIDAMNOS”.	215	215	100	215	215	Realizuar 100%
27.	Blerje pajisje hardware për rrjetet e paklasifikuara në FA.	14,679	14,679	100	110	110	Realizuar 100%
28.	Projekt për mbështetje me burime ushqimi elektrik BUE	14,745	14,745	100	1	1	Realizuar 100%
29.	Licenca dhe programe softwerike për FA-në.	30,000	20,160	67	5	3	Realizuar 67%
30.	Pajisje me elemente të sistemit të sigurisë elektronike në Repartin Usharak 6630, garnizonin “Skënderbej”, OFFA dhe SHPU.	10,000	0	0	0	0	
31.	Pajisje hotelerie për SHPU Jalë, Durrës, Pogradec dhe Vlorë.	10,942	5951	54	400	216	Realizuar 54%
32.	Sistemi i infrastrukturës + postblloku nr.4 + drenazhim i fushës së futbollit garnizoni “Skënderbej”.	54,000	0	0	0	0	Nuk është realizuar
33.	Përmirësim dhe riparim i sistemit të çillerave në garnizonin “Skënderbej”.	4,000	0	0	0	0	Nuk është realizuar
34.	Pajisje zyrash të Njësisë Ushtarake të Sigurisë Kibernetike.	10,000	0	0	0	0	Ky projekt është dërguar për prokurim pranë ASHPP.
35.	Kondicioner zyrash 9-BTU	700	0				Akti Normativ nr.6, datë 14.12.2023
36.	Kondicioner Dollap SO (30-40) BTU	700	0		0		Akti Normativ nr.6 datë 14.12.2023
37.	Pajisje dhe softe për përmirësimin e sistemit në AISM	11,000	0		0		Akti Normativ nr.6, datë 14.12.2023
	Totali i shpenzimeve kapitale	1,091,100	740,756	68			
	Totali i shpenzimeve (korrente + kapitale)	6,632,808	6,178,973	93			

Fondet e miratuara për këtë program përbëjnë rreth 19 % të buxhetit me ndryshime të miratuara për realizimin e objektivave të mësipërme për vitin 2023 janë parashikuar gjithsej 71 nëpërmjet 13 produkteve në zërat “Shpenzime Korrente” dhe 37 projekte investimi në zërin “Shpenzime Kapitale”. Për këtë program vërejmë se ndryshimi i planit të produkteve është shtuar në vlerën 15,454 mijë lekë në shpenzime operative. Janë pakësuar 21 projekte në zërin “Investime”, me vlerë totale 565,364 mijë lekë .

Realizimi i fondeve buxhetore sipas grup artikujve për 12-mujorin e vitit 2023 në këtë program buxhetor duke e krahasuar me buxhetin vjetor të miratuar rezulton, si më poshtë:

Realizimi i fondeve buxhetore për grupin e shpenzimeve korrente	98%
Realizimi i fondeve buxhetore për grupin e shpenzimeve kapitale	68 %

Gjithsej	93%
-----------------	------------

4. PROGRAMI “MBËSHTETJE PËR SHËNDETËSINË”

Fondet e akorduara për këtë program buxhetor përbëjnë rreth 4.2 % të buxhetit me ndryshime të miratuara për periudhën raportuese. Programi “Mbështetje për Shëndetësinë” ka parashikuar objektiva specifike dhe plane veprimi për realizimin e tyre. Për vitin 2023 objektivat kryesorë janë:

- Objektivi 1: Pritja dhe trajtimi i pacientëve të politraumatizuar në kohë reale pranë Urgjencës së SUT-së
- Objektivi 2: Trajtimi shëndetësor dhe spitalor i pacientëve të afruara nga specialitetet mjekësore pranë SUT-së

Fondet e miratuara për këtë program shpenzohen për realizimin e objektivave të mësipërm, nëpërmjet 1 produkti në zërat “Shpenzime Korrente” dhe 3 projekte investimi në zërin “Shpenzime Kapitale”. Për këtë program vërejmë se ndryshimi i planit të produkteve ka ndryshuar sipas tabelës:

Për 12-mujorin e vitit 2023 janë parashikuar 4 produkte me vlerë të rishikuar **1,480,090 mijë lekë** dhe janë realizuar 4 produkte, me vlerë **1,464,504 mijë lekë** ose 98.95 %.

Nga analiza e kostos së produkteve të planifikuara me koston e produkteve në fakt nuk ka ndryshime dhe në mënyrë analitike realizimi i produkteve të programit buxhetor “Mbështetje për Shëndetësinë” paraqitet në tabelën e mëposhtme:

Tabela nr. 9

në 000/lekë

Nr.	Produktet	Buxheti 12-mujor në (000/leke)	Realizimi 12-mujor viti 2023		Kosto për njësi		Komente për realizimin e produkteve
			Realizimi 12- mujor në (000/lekë)	Në %	Kostoja për njësi në Plan	Kostoja për njësi në Fakt	
1.	Infrastrukturë shëndetësore, logjistike funksionale për trajtimin e pacientëve ambulatorë dhe të shtruar për shërbimin e urgjencës pranë SUT /91704AA.	1,309,390	1,297,882	99	6	13	Realizuar
2.	Rikonstrukcion godinash. Kodi I8AZ813.	54,934	54,086	99	1	1	Realizuar
3.	Blerje mobilie. Kodi 18AZ814.	15,766	15,765	100	11	12	Realizuar
4.	Blerje pajisje dhe aparatura mjekësore. Kodi 18AZ817.	100,000	96,771	97	1,250	337	Realizuar
TOTALI		1,480,090	1,464,504				

Realizimi i fondeve buxhetore sipas grup artikujve për 12-mujorin në këtë program buxhetor rezulton, si më poshtë:

Në shpenzime operative është realizuar 1 produkt. me vlerë 1,297,881,982 mijë lekë ose 99.12%.
Në shpenzime kapitale janë realizuar 3 projekte. me vlerë 166,622,398 mijë lekë ose 97.61 %.

Statusi i realizimit të këtyre produkteve është në vlerën 1,464,504,380 lekë ose 98.95 %.

5. **PROGRAMI “ARSIMIMI USHTARAK”**

Programi “Arsimimi Ushtarak” synon rritjen e kapaciteteve të burimeve njerëzore dhe transformimi i sistemit të edukimit ushtarak e civil, nëpërmjet programeve të integruara dhe gjithëpërfshirëse, në përputhje me standardet e NATO-s.

Për vitin 2023 objektivat kryesorë janë:

Arsimimi në të tri ciklet e studimit dhe kualifikimin në fushën e mbrojtjes e të sigurisë kombëtare të personelit ushtarak e civil, për të gjitha nivelet e drejtimit dhe komandimit të FARSH-it dhe institucioneve të tjera të sigurisë kombëtare.

- Kualifikimi dhe përgatitja, menaxhimi, zhvillimi dhe vlerësimi i stërvitjes individuale bazë me rekrutët kandidatë për ushtarë/detarë aktivë dhe stërvitjes individuale të avancuar në bashkëpunim me strukturat e FA-së.
- Përgatitja e personelit ushtarak dhe civil në FA, në përputhje me detyrat që burojnë nga misionet kushtetuese të strukturave të Forcave të Armatosura në kuadër të mbrojtjes kolektive të NATO-s dhe sigurisë kombëtare, si dhe për pjesëmarrjen në operacionet e emergjencave civile.
- Modernizimi dhe zhvillimi i kapaciteteve për arsimim, trajnim, stërvitje dhe kualifikim në të gjitha strukturat e AFA-së, bazuar në kërkesat e ligjit nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë.
- Bashkërendimi i veprimtarinë së AFA-së me MASR-në dhe me institucione të tjera të të gjitha niveleve brenda dhe jashtë vendit, për realizimin cilësor të programeve akademike.

Fondet e miratuara për këtë program shpenzohen për realizimin e objektivave të mësipërme, nëpërmjet 1 produkti në zërat “Shpenzime Korrente” dhe 3 projekte investimi në zërin “Shpenzime Kapitale”. Për këtë program vërejmë se ndryshimi i planit të produkteve është shtuar në vlerën 1,054 mijë lekë në shpenzime operative, në art 606 “Transferta për Buxhete Familjare dhe Individë”.

Për 12-mujorin e vitit 2023 janë realizuar 7 produkte, me vlerë 468,133 mijë lekë ose 57%.

Nga analiza e kostos së produkteve të planifikuara me koston e produkteve në fakt nuk ka ndryshime dhe në mënyrë analitike realizimi i produkteve të programit buxhetor “Arsimimi Ushtarak” paraqitet në tabelën e mëposhtme:

Tabela nr. 10

në 000/lekë

Nr.	Produktet	Buxheti 12-mujor (000/lekë)	Realizimi 12-mujor, viti 2023		Kosto për njësi		Komente për realizimin e produkteve
			Realizimi 12- mujor (000/lekë)	Në %	Kostoja për njësi në Plan	Kostoja për njësi në Fakt	
1.	Kapacitete të afta për trajnimin dhe arsimimin cilësor në Forcat e Armatosura.	761,559	725,846	95	1,147	1,230	Realizuar
2.	Ndërtim i godinës së re shumë funksionale të AFA (Prona 21).	239,868	239,618	100	16,821	16,804	Realizuar
3.	Rikonstruksion Objekti nr. 8, garnizoni “Skënderbej”	9	8	89	11	1	Realizuar
4.	Rikonstruksion i rrjetit LAN të QS.	2,200	0	0	2,200	0	I parealizuar
5.	Blerje 35 licenca VBS3 dhe 15 laptopë për VBS3.(MTT)	39	0	0	0,7	0	I parealizuar
6.	Zëvendësimi i pajisjeve elektronike KDS (kompjuter, printer, fotokopje, projektor	2,134	1,296	61	534	648	Realizuar pjesërisht
7.	Blerje pajisje kompjuterike (48 work Station CPU, 2 Server pajisje të tjera	15,750	15,749	100	315	315	Realizuar
TOTALI		1,021,559	982,517	96			

Realizimi i fondeve buxhetore sipas grup artikujve për 12-mujorin në këtë program buxhetor rezulton, si më poshtë:

- Në shpenzime operative në vlerë **725,846** mijë lekë ose 96%.
- Në shpenzime kapitale në vlerë **256,671** mijë lekë ose 99%.

Statusi i realizimit të këtyre produkteve është në vlerën 982,517 mijë lekë ose 96%

Trajtimi i çështjes së barazisë gjinore.

Nga programi “Arsimimi Ushtarak” janë përcaktuar tregues konkretë të përshtatshëm dhe të matshëm të cilët janë identifikuar, produktet me kostot përkatëse që kontribuojnë në realizimin e tyre. Për këtë program kemi arritje të planit të produkteve nga produkti të planifikuar.

Statusi i realizimit të këtyre produkteve është në 96 % ndaj buxhetit me ndryshime të Ministrisë së Mbrojtjes, për vitin 2023.

6. PROGRAMI “MBËSHTETJE SOCIALE PËR USHTARAKËT”.

Fondet e miratuara për këtë program shpenzohen për realizimin e objektivave të mësipërme, nëpërmjet 5 produkteve. Për këtë program vërejmë se nuk ka ndryshim të planit të produkteve.

Fondet e akorduara për këtë program buxhetor përbëjnë rreth 13.6 % të buxhetit me ndryshime të miratuar për periudhën raportuese. Programi “**Mbështetje Sociale për Ushtarakët**” ka parashikuar objektiva specifike.

Për vitin 2023 objektivat kryesorë janë:

- Menaxhimi me eficiencë dhe efektivitet i burimeve njerëzore dhe financiare.
- Trajtim të veçantë të ushtarakëve në rezervë dhe në lirim.
- Transferta të brendshme për përballimin e pensioneve të parakohshme të ushtarakëve.

Nga analiza e kostos së produkteve të planifikuara me koston e produkteve në fakt kanë ndryshuar kostot nga shtesa e fondit për katër produkte dhe në mënyrë analitike realizimi i produkteve të Programit buxhetor “Arsimimi Ushtarak” paraqitet në tabelën e mëposhtme:

Tabela nr. 11

në 000/ lekë

Produktet	Buxheti 12-mujor i rishikuar, viti 2023	Realizimi i vitit 2023	
		Në 000/lekë	Në %
Sigurimin suplementar të ish-ushtarakëve dhe ish-policëve.	2,330,838	2,407,944	103
Përfitime të llogaritura dhe shpërndara për trajtimin e veçantë të pilotëve fluturues në pension.	99,008	100,591	102
Përfitime të llogaritura dhe shpërndara për trajtimin e veçantë i punonjësve të industrisë ushtarake.	75,385	76,782	102
Përfitime të llogaritura dhe shpërndara për trajtimin e veçantë të ushtarakëve të nëndetëseve në pension.	12,668	12,890	102
Kontributet e buxhetit të shtetit në bazë të legjislacionit për financimin e ushtarakëve në pension të parakohshëm.	2,682,101	2,682,101	100
Totali	5,200,000	5,280,308	102

Për 12-mujorin e vitit 2023 janë parashikuar 5 produkte, me vlerë 5,200,000 mijë lekë dhe janë realizuar 5 produkte, me vlerë 5, 280,308 mijë lekë ose 102%, pasi ka ndryshuar i planit vjetor me fonde shtesë në vlerën 80,308 mijë lekë si shtesë në art.604, për vitin 2023.

Realizimi i fondeve buxhetore sipas artikullit 604, për vitin 2023, në këtë program buxhetor rezulton, si më poshtë:

Nr .	Produktet	Buxheti 12-mujor në (000/lekë)	Realizimi 12- viti 2023		Kosto për njësi		Komente për realizimin e produkteve
			Realizimi 12-mujor në (000/lekë)	Në %	Kostoja për njësi në Plan	Kostoj a për njësi në Fakt	
1.	91706AB - Sigurimin suplementar të ish-ushtarakëve dhe ish-policëve.	2,330,838	2,407,944	103	106,053	109,562	Ndryshimi i kostos si rezultat i shtesës së fondit për këtë produkt
2.	91706AC - Përfitime të llogaritura dhe shpërndara për trajtimin e veçantë të pilotëve fluturues në pension.	99,008	100,591	102	434,246	441,189	Ndryshimi i kostos si rezultat i shtesës së fondit për këtë produkt
3.	91706AD - Përfitime të llogaritura dhe shpërndara për trajtimin e veçantë i punonjësve të industrisë ushtarake.	75,385	76,782	102	248,795	253,406	Ndryshimi i kostos si rezultat i shtesës së fondit për këtë produkt
4.	91706AE - Përfitime të llogaritura dhe shpërndara për trajtimin e veçantë të ushtarakëve të nëndetëseve në pension.	12,668	12,890	102	243,615	247,885	Ndryshimi i kostos si rezultat i shtesës së fondit për këtë produkt
5.	91706AF - Kontributet e buxhetit të shtetit në bazë të legjislacionit për financimin e ushtarakëve në pension të parakohshëm.	2,682,101	2,682,101	100	396,585	396,585	Realizuar
TOTALI		5,200,000	5,280,308	102			

Realizimi i fondeve buxhetore për grupin e shpenzimeve korrente **102%**.

7. PROGRAMI “EMERGJENCA CIVILE”.

Programi “Emergjencia Civile” përmban 2 nënprograme: Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile dhe Drejtoria e Përgjithshme e Rezervave Materiale të Shtetit, për vitin 2023 objektivat kryesorë janë:

- Objektivi 1: Zvogëlimi i humbjeve në jetë njerëzish, pasurisë, trashëgimisë kulturore dhe në mjedis.
- Objektivi 2: Rritja e stokut në mallra ushqimore e industriale dhe krijimi i kushteve optimale për miradministrimin e mallrave të konsideruara si rezervë shtetërore.

Fondet e miratuara për vitin 2023 për këtë program përbëjnë 11.4% të buxhetit të Ministrisë së Mbrojtjes dhe shpenzohen për realizimin e objektivave të mësipërm, nëpërmjet 5 produkteve në zërat “Shpenzime Korrente” dhe 9 projekte investimi në zërin “Shpenzime Kapitale”. Për këtë program vërejmë se ndryshimi i planit të produkteve është ulur në vlerën 260,868 mijë lekë.

Për 12-mujorin e vitit 2023, janë parashikuar 14 produkte me vlerë **2,519,524 mijë** lekë dhe janë realizuar 10 produkte me vlerë **1,737,905 mijë** lekë ose 69 %.

Nga analiza e kostos së produkteve të planifikuara me koston e produkteve në fakt nuk ka ndryshime dhe në mënyrë analitike realizimi i produkteve të programit buxhetor “Emergjencia Civile” paraqitet në tabelën e mëposhtme:

Tabela nr. 12

në 000/lekë

Nr.	Produktet	Buxheti 12-mujor në (000/leke)	Realizimi 12-mujor viti 2023		Kosto për njësi		Komente për realizimin e produkteve
			Realizimi 12- mujor në (000/lekë)	Në %	Kostoja për njësi në Plan	Kostoja për njësi në Fakt	
1	Mbrojtja e jetës njerëzore, pronës, trashëgimisë kulturore dhe pyetje ndaj zjarrit.	476,334	444,010	0.93	103	103	Realizuar
2	Shtetas të ndihmuar, banesat e të cilëve janë dëmtuar nga fatkeqësi të ndryshme.	302,504	248,973	0.82	1440	1440	Realizuar
3	Shpenzime për marrjen e masave parandaluese, lehtësuese mbrojtëse dhe rehabilituese në objekte të ndryshme nëpërmjet blerjes së materialeve dhe shërbimeve të ndryshme, për mbrojtjen e jetës dhe pronës së njerëzve.	496,496	260,618	0.53	1440	1440	Realizuar
4	Stoku i mallrave ushqimore (rezervë materiale shtetërore).	20,310	17,980	0.89	32	32	Ky projekt është realizuar në masën 74%.
5	Stoku i mallrave industriale (rezervë materiale shtetërore).	80,580	79,466	0.99	1	1	Ky produkt është realizuar në masën 89%.
6		1,376,224	1,051,047	76%			
7	Masa parandaluese, mbrojtëse dhe rehabilituese në disa bashki të vendit.	1,012,131	634,817	63%	113	113	Ky projekt është realizuar në masën 63%.
8	Bashkëfinancim, TVSH dhe taksa doganore.	10,000	6,374	64%	5000	5000	Ky projekt është realizuar në masën 64%.
9	Aplikimi I sistemeve të informacionit gjeografik (GIS) dhe Web GIS.	18,000	-	0%			Nuk është realizuar
10	Blerje software baza e të dhënave të humbjeve nga fatkeqësitë.	8,300	-	0%			Nuk është realizuar

11	Blerje sistem për video konferenca.	1,200	-	0%			Nuk është realizuar
12	Bashkëfinancim me projektet e huaja.	58,829	29,617	50%	5319	5319	Ky projekt është realizuar në masën 50%.
13	Blerje mallra rezervë shteti ushqimore.	18,840	13,979	74%	133	133	Ky projekt është realizuar në masën 74%, si pasojë e dështimit të procedurës së prokurimit për disa lote.
14	Blerje mallra rezervë shteti industrial.	14,000	0	0%	0	0	Ky projekt rezultoi i pa realizuar për vitin 2023. Arsyeja është shpallja me vonesë e fituesit.
15	Blerje ushqim për bagëti.	2,000	1,869	93%	69	69	Ky projekt është realizuar në masën 93%.
16	Financim i huaj për AKMC	1,900,000	0				
231		3,043,300	686,656	69%			
TOTALI		4,419,524	1,737,703	60%			

Realizimi i fondeve buxhetore sipas grup artikujve për 12-mujorin në këtë program buxhetor rezultoi, si më poshtë:

- Në shpenzime operative janë realizuar 4 produkte, me vlerë **1,051,250** mijë lekë ose 76.4%.
- Në shpenzime kapitale janë realizuar 10 projekte, me vlerë **686,657** mijë lekë ose 60.1%.

Statusi i realizimit të këtyre produkteve është në vlerën 1.737.906 mijë lekë ose 60%.

2. KRAHASIMI I TË DHËNAVE FAKTIKE NDËRMJET MINISTRISË DHE THESARIT

Nga të dhënat faktike (financim i brendshëm + huaj) të shtatë programeve të Ministrisë së Mbrojtjes me situacionet raportuese të thesarit për vitin 2023 paraqiten:

Tabela nr.13

në 000/lekë

Nr.	Emërtimi i programit	Shpenzime korrente			Shpenzime kapitale			Totali shpenzimeve		
		Ministria	Thesari	Dif.	Ministria	Thesar	Dif.	Ministria	Thesari	Dif.
1.	Planifikim, Menaxhim dhe Administrim	1,416,355	1,416,355	0	179789.5	179789.5	0	1,596,145	1,596,145	0
2.	Forcat e Luftimit	5,841,330	5,841,330	0	7,465,100	7465099.8	0	13,306,430	13,306,430	0
3.	Mbështetja e Luftimit	5,438,218	5,438,218	0	740,756	740755.5	0	6,178,973	6,178,973	0
4.	Arsimi Ushtarak	725,844	725,844	0	256,671	256670.8	0	982,515	982,515	0
5.	Mbështetje për Shëndetësinë	1,297,872	1,297,872	0	166,622	166622.3	0	1,464,495	1,464,495	0
6.	Mbështetje për Ushtarakët	5,280,308	5,280,308	0	0	0	0	5,280,308	5,280,308	0
7.	Emergjencat Civile	1,051,048	1,051,048	0	686,657	686656.8	0	1,737,704	1,737,704	0
TOTALI		21,050,975	21,050,975	0	9,495,595	9,495,595	0	30,546,570	30,546,570	0

Ashtu siç vërtetohet nga tabela e mësipërme, të dhënat e paraqitura nga shtatë programet e Ministrisë së Mbrojtjes për përgatitjen e raportit të monitorimit të shpenzimeve për vitin 2023 përputhen plotësisht me të dhënat e thesarit për këtë periudhë raportuese.

3. INFORMACION MBI VOLUMIN DHE MADHËSINË E NDRYSHIMIT TË BUXHETIT

Për shtatë programet e Ministrisë së Mbrojtjes situata në lidhje me ndryshimet në planifikimin e buxhetit gjatë vitit 2023, përfshirë këtu buxhetin fillestar, buxhetin me ndryshime gjatë periudhës raportuese të këtij viti, paraqitet në tabelën e mëposhtme:

Tabela nr.14

(në 000 / lekë)

Nr.	Emërtimi i programit	Buxheti fillestar viti 2023 (plani)	Buxheti me ndryshime viti 2023	(Ndryshimet)
1.	Planifikim, Menaxhim dhe Administrim	1,603,724	1,687,880	84,156
2.	Forcat e Luftimit	18,260,500	14,735,582	(3,524,918)
3.	Mbështetja e Luftimit	7,659,659	6,632,808	(1,026,851)
4.	Arsimimi Ushtarak	1,363,420	1,021,559	(341,861)
5.	Mbështetje për Shëndetësinë	1,608,536	1,480,090	(128,446)
6.	Mbështetje për Ushtarakët	5,200,000	5,280,308	80,308
7.	Emergjencat Civile	4,560,300	4,419,524	(140,776)
TOTALI		40,256,139	35,257,751	(4,998,388)

Në total ministrie, ndryshimi i buxhetit 12-mujor paraqitet me ulje në vlerën **4,998,388 mijë lekë** më pak se buxheti fillestar. Këtë ndryshim po e analizojmë sipas artikujve të secilit program

Tabela nr.15

(në 000 / lekë)

	NDRYSHIMET									
	600	601	602	603	604	605	606	231B	231H	Totali
Planifikim, Menaxhim dhe Administrim	-89,411	13,000	161,000	0	0	0	25,567	0	0	84,156
Forcat e Luftimit	-91,900	66,300	297,800	0	0	0	47,582	255,300	-4,100,000	-3,524,918
Mbështetja e Luftimit	180,000	43,900	-1,124,705	0	0	0	5,354	-131,400	0	-1,026,851
Arsimimi Ushtarak	-149,500	2,500	0	0	0	0	45,139	-240,000	0	-341,861
Mbështetje për Shëndetësinë	-13,500	-6,000	100,000	0	0	0	1,054	-210,000	0	-128,446
Mbështetje për Ushtarakët	0	0	0	0	80,308	0	0	0	0	80,308
Emergjencat Civile	73,920	-1,200	-29,900	0	-1,000	29,900	3,504	-216,000	0	-140,776
TOTALI										0
	-90,391	92,500	-595,805	0	79,308	29,900	128,200	-542,100	-4,100,000	-4,998,388

Në total ministrie, ndryshimi i buxhetit 12-mujor paraqitet me ulje në vlerën **4,998,388** mijë lekë në krahasim me buxhetin fillestar. Këtë ndryshim po e analizojmë sipas artikujve buxhetorë të mëposhtëm:

Në artikullin 600 kemi pakësim fondi në shumën **90,391** mijë lekë;

Në artikullin 601 kemi shtesë fondi në shumën **92,500** mijë lekë;

Në artikullin 602 kemi pakësim fondi në shumën **595,805** mijë lekë;

Në artikullin 604 kemi shtesë fondi në shumën **79,308** mijë lekë;

Në artikullin 605 kemi shtesë fondi në shumën **29,900** mijë lekë;

Në artikullin 606 kemi shtesë fondi në shumën mijë lekë, që ka të bëjë me detajimin fillestar të fondit të veçantë në shumën **128,200** mijë lekë.

Në artikullin 231 kemi pakësim fondi në shumën **4,642,100** mijë lekë nga të cilat: pakësim në shumën **542,100** mijë lekë në investime me financim të brendshëm dhe pakësim në shumën **4,100,000** mijë lekë në investime me financim të huaj.

Shkresat në të cilat pasqyrohet ndryshimi i buxhetit për vitin 2023 janë:

- Memo e sekretarit të përgjithshëm nr.750/1prot., datë 6.2.2023 “Rishpërndarje fondeve buxhetore nga programi “Mbështetja e Luftimit”, te njësia e re shpenzuese “Kolegji i Mbrojtjes dhe i Sigurisë”.
- Shkresë nr. 2421/ prot., datë 26.04.23 “Rishpërndarje fondesh për vitin 2023”.
- Shkresë e sekretarit të përgjithshëm nr.3315 prot., datë 12.6.2023 “Dërgohet miratim detajimi i fondit të veçantë të ushtarakëve të MM dhe civilëve të AISM”.
- Shkresë e sekretarit të përgjithshëm të MM nr. 2946/4 prot., datë 20.6.2023 “Rialokim Fondi për vitin 2023”; shkresa e MFE nr. 9481/1prot., 31.5.2023 “Rialokim Fondi për vitin 2023”.
- Shkresë e sekretarit të përgjithshëm nr. 3090/2 prot., datë 20.6.2023 “Kërkesë për rishpërndarje fondesh”, për AKMC-në.
- Shkresë e sekretarit të përgjithshëm të MM nr. 3649/1 prot., datë.13.7.2023 “Rishpërndarje në artikullin 602 “Mallra e shërbime”.

- Shkresë e sekretarit të përgjithshëm të MM nr. 4025/1 prot., datë 18.7.2023 “Rialokim Fondi”, në lidhje me VKM nr. 325, datë 31.5.2023.
- Memo e sekretarit të përgjithshëm të MM nr. 4111 prot., datë 20.7.2023 “Rishpërndarje fondi në art.602 “Mallra e shërbime”, shkresë e sekretarit të përgjithshëm nr.4827/2 prot., datë 26.9.2023 “Rishpërndarje fondi për art. 602 “Mallra e shërbime”.
- VKM 553 dt. 28.09.2023”Për indeksimin e pensioneve” shtesë fondi 80,308 mijë lekë.
- Shkresa e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë “Rialokim fondi për vitin 2023”, nr.18180/1, dt.17.10.23, dërguar me shkresën e MM nr. 5175/1, datë 05.10.2023
- Shkresa e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë Akti Normativ nr. 5 datë 18.10.2023, “Dërgohet miratimi i detajimit të ndryshimeve sipas AN 5, datë 18.10.2023;
- Shkresa e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr.22656/91, datë 28.12.23, mbi Akti Normativ nr.6, datë 14.12.2023, “Dërgohet miratimi i detajimit të ndryshimeve sipas AN nr.6, datë 14.12.2023”; dërguar me shkresën e MM nr.6979/1, datë 21.12.2023.
- Rishpërndarje fondesh sekretarit të përgjithshëm të MM nr.6264/1, datë.15.11.2023

Ndryshimet në buxhet në art. 231 “Shpenzime kapitale”, investime deri me datë 31.8.2023, “Për rishpërndarje të fondit buxhetor”, miratuar si më poshtë detajuar:

- Shkresa e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr, 3389/1 prot., datë 06.04.2023, dërguar me shkresën e MM nr. 101/1 prot., datë 10.01.2023.
- Shkresa e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr.6402/1prot., datë 07.04.2023, dërguar me shkresën e MM nr. 1872/ 2 prot., datë 04.04.2023.
- Shkresa e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr.4233/2 prot., datë 05.04.2023 (bashkitë) dërguar me shkresën e MM nr. 818/ 2 prot., datë 01.03.2023.
- Shkresa e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr.9022/1, datë 12.06.2023 (bashkitë), dërguar me shkresën e MM nr. 2789 prot., datë 16.05.2023.
- VKM nr.392, datë 29.06.2023, efektet në shtator, dërguar MFE nr.12140/1 prot., datë 07.07.2023.
- Shkresa e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 14234/1 prot., datë 25.08.2023, dërguar me shkresën e MM nr. 4238/2 prot., datë 01.08.2023.
- VKM 392, datë 29.06.2023” Për rishpërndarje fondi buxhetor”, referuar shkresës MFE nr.12140/1, datë 07.07.23.
- Shkresa e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 14234/1, datë 25.08.2023.
- Shkresa e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 15595/1, datë 17.10.2023.
- Shkresa e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë 19139 /47, datë 02.11.2023, në zbatim të aktit normativ nr.5, datë 18.10.2023.
- Shkresa e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr.19246/1, datë 31.10.2023.
- Shkresa e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr.20674/1, datë 24.11.2023.
- Shkresa e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë MFE nr.22656/76, datë 28.12.2023 në zbatim të aktit normativ nr.6.
- Shkresa e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë “Rialokim fondi për vitin 2023”, nr.18180/1dt.17.10.23, dërguar me shkresën e MM nr.5175/1, datë 05.10.2023.
- Rishpërndarje fondesh sipas shkresës së MM nr.6264/1, datë.15.11.2023.

INVESTIMET E HUAJA

Krahasuar të dhënat në Sistemin Informatik Financiar Qeveritar (SIFQ) me vlerat e pasqyruara në ligjin e buxhetit 84/2022 “Për buxhetin 2023”, evidentohet ndryshimi (pakësimi) në “Shpenzimet kapitale me financim të huaj **në shumën 6,000,000 mijë lekë**”. Këto projekte nuk kanë plan të miratuar dhe nuk raportohen nëpërmjet sistemit të thesarit, në programin “Forca e Luftimit”, pakësim në shpenzime kapitale në shumën 4,100,000 mijë lekë në projektin me kod 18AZ208 “Kapacitete të ofruara në modernizim”.

INFORMACION MBI DETYRIMET E PRAPAMBETURA TË KRIJUARA RISHTAZI JANAR - DHJETOR 2023

Detyrimet e prapambetura e të krijuar rishtazi për periudhën janar-dhjetor 2023, të raportuara nga njësitë shpenzuese të Ministrisë së Mbrojtjes, janë në vlerën rreth 628,198 mijë lekë. Sipas natyrës këto detyrime kategorizohen, si më poshtë:

- . Detyrime për “Shpenzime personeli”, në vlerën 151 milionë lekë, të cilat janë detyrime të akumuluar për pagesë kontributesh.
- A. Detyrime në zërin “Mallra dhe shërbime”, në vlerën 67 milionë lekë, detyrime për kontrata dhe fatura të papaguara.
- . Detyrime në zërin “Vendime gjyqësore”, në vlerën 55 milionë lekë, pjesa më e madhe e detyrimit janë shpenzime në artikullin 604, për përballimin e fatkeqësive natyrore, detyrime që janë krijuar nga ish-DPEC.

Gjatë vitit 2023 me fondet e akorduara të këtij viti, janë likuiduar nga njësitë shpenzuese të Ministrisë së Mbrojtjes, detyrime të prapambetura në vlerën 186,770,883 lekë.

Theksojmë se këto detyrime i përkasin detyrimeve të prapambetura të trashëguara ndër vite.

Për vitin 2023, janë bërë kërkesat përkatëse në fazën II, të Programit Buxhetor Afatmesëm 2024-2026, por referuar analizave të realizimit të pritshëm të buxhetit, do të shihet mundësia e rialokimit të fondeve midis artikujve, me qëllim likuidimin total të detyrimeve të prapambetura.

Si konkluzion:

Në total realizimi i buxhetit (FB+FH) të vitit 2023 për Ministrinë e Mbrojtjes është në masën 92 % të specifikuar sipas kategorive kryesore të shpenzimeve, si më poshtë:

- a) **Shpenzimet korente janë realizuar në masën 92 %**, prej të cilave:
 - **Shpenzime personeli (600-601)** në masën 99%. Realizimi është në nivelin e pritshëm me përjashtim të mangësive në struktura të personelit të paplotësuar.
 - **Shpenzime të tjera (602-606)** në masën 93 %. Siç shihet nga anekset përkatëse, mosrealizime të theksuara ka në shpenzimet për mallra e shërbime (art. 602), të cilat i përkasin programeve:

“Emergjencat Civile” në shumën 2,681,820 mijë lekë dhe programi buxhetor “Forcat e Luftimit” në shumën 1,429,152 mijë lekë si mosrealizim të procedurave të prokurimit dhe mosrealizim të pagesave.

b) Shpenzimet kapitale me financim të brendshëm janë realizuar në masën 84%

Për sa i përket shpenzimeve kapitale me financim të brendshëm me plan vjetor në shumën 11,887 milionë lekë dhe plan 12-mujor në shumën 11,345 milionë lekë kanë një realizim prej 1,845 milionë lekë ose në masën 84 %. Mosrealizimi i fondit ndikohet nga kursimet e fondeve nga procedurat e prokurimit.

c) Shpenzimet kapitale me financim të huaj janë realizuar në masën 0 %.

Investimet me financimin e huaj, me plan vjetor në shumën 6,000 milionë lekë dhe plan 12-mujor prej 190 milionë lekë, paraqiten me një realizim në shumën 0 milionë lekë ose në masën 0 % ndaj planit vjetor.

Në vlerësimin përfundimtar konstatojmë se realizimi i buxhetit në fund të kësaj periudhe është në nivelin normal, por jo të pritshëm, sidomos në zërin “Investime të brendshme” dhe mosrealizimit të shpenzimeve për “Mallra e shërbime” për të gjitha shkaqet që u sqaruan gjatë këtij raporti.

Në bazë të vlerësimit të të dhënave të realizimit të shpenzimeve buxhetore gjatë çdo muaji, është ndjekur sistematikisht dhe me përgjegjësi menaxhimi i fondeve buxhetore.

Problematikat e konstatuara gjatë këtij 12-mujori do të jenë objekt i vëmendjes dhe trajtimit, me qëllim shmangien e përsëritjes së tyre në vijim.

Duke Ju falënderuar për bashkëpunimin.

SEKRETARI I PËRGJITHSHËM

Gelardina Prodani

Konceptoi: Rita Rosaj

Miratoi: Nuri Laknori